



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI I RIJOK PËR DREJTAT E NJERIUT

YPOCIVACIONI I RIJOK PËR DREJTAT E NJERIUT
JOINT ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS



Raport monitorues



*mbi punën e ekzekutivit të komunës së
Lipjanit*

Tetor 2014

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Përmbledhje ekzekutive,
- Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti,
- Problemet aktuale,
- Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit
- Administrata komunale
- Arsimi
- Shëndetësia
- Tatimi në pronë
- Burimet:

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140

e-mail: info.yahr@gmail.com

Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"




Organizata Jogeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit, gjatë periudhës katër vjeçare 2013/2017 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së ekzekutivit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së ekzekutivit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit. Në këtë drejtim, në formë të renditur nëpërmes këtij raporti ofrojmë të dhëna të cilat pasqyrojnë disa aspekte të punës së ekzekutivit. YAHR nëpërmjet monitorimit pro aktiv dhe por edhe në bashkëpunim me institucionin e Kuvendit si dhe palë të përfshira në këtë proces, YAHR ka arritur t'i siguroj këto informacione, të cilat do të mund të zhvilloheshin edhe më tej, në rast të një bashkëpunimi më cilësor nga ana e institucioneve, apo edhe në rast të organizimit dhe funksionimit të tyre më të mirëfilltë. Nëpërmes aktiviteteve monitoruese YAHR është përfshirë në këto drejtime si puna në seanca plenare dhe puna në Komitetet.

Në hartimin e këtij raporti të dhjetë monitorues për punën e ekzekutivit të Kuvendit komunal të Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimin e mbledhjeve të bordit të drejtorëve, monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të mediave të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it



Hyrje

OJQ Youth Association for Human Rights (YAHR) për gjatë pjesës së parë të vitit 2014 nëpërmjet monitoruesve të saj nga afër ka përcjellë punën e ekzekutivit si dhe funksionimin e legjislativit të komunës së Lipjanit. Ky monitorim ka pasur për qëllim të identifikojë jo vetëm të metat eventuale të qeverisjes si dhe shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi por edhe të shënojë ngritjen e institucioneve si në aspektin e rritjes së kapaciteteve, shfrytëzimit të buxhetit dhe aplikimit të frymës demokratike të marrjes së vendimeve si dhe të komunikimit dhe të transparencës. Gjatë procesit të monitorimit YAHR-i ka synuar të rrisë besueshmërinë e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes por edhe të sigurojë një prani të përhershme të një mbikëqyrje transparente të funksionimit të pushteteve me theks të veçantë të transparencës në raport me qytetarin. Duke u nisur nga bindja se procesi i monitorimit është i domosdoshëm për këtë shkallë të zhvillimit të demokracisë sonë, derisa ende institucionet tona përballen me ngërçe institucionale dhe me mos- transparencë, YAHR-i konsideron se me punën e monitorimit është mundësuar një dobi e dyfishtë edhe në raport me institucionet por edhe me qytetarin. Institucionet komunale kanë pasur mundësi të dëgjojnë një zë jo kundërshtues apo refuzues arbitrar, por një zë të këshillës dhe të sugjerimit për të avancuar proceset. Ndërkaq qytetari ka fituar një zë të sigurt, një vlerësim bindës për zhvillimet brenda institucioneve komunale duke mësuar kështu më mirë se kah dhe ku harxhohet paraja publike, apo si janë caktuar prioritetet e projekteve. Gjatë punës së tij YAHR-i ka hasur edhe në bashkëpunime të hapura të sinqerta dhe transparente dhe shih për këtë i falënderon të gjithë ata që kanë ofruar të dhëna dhe sqarime në çdo moment, për ne shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për të kryer misionin tonë prej monitoruesi.

Vendimmarrja e cila prekë interesat e qytetarëve duhet të merret sa më afër tyre, këtë e siguron parimi i subsidiaritetit. Kjo u mundëson qytetarëve që të përfitojnë shërbime publike më të mira dhe në mënyrë më efikase dhe transparente nga organet komunale.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit bazuar në monitorimin e punës së Komunës së Lipjanit gjatë periudhës Qershor – Tetor 2014. Monitorimi është fokusuar në Ekzekutivin e Komunës, dhe përfshinë fushat: e premtimeve të kryetarit të komunës, transparencës dhe llogaridhënies, demokratizimit dhe qeverisjes së mirë, zhvillimit urban e ekonomik, arsimit dhe shëndetësisë.

YAHR vlerëson se qeverisja në Komunën e Lipjanit, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 është përballur me shumë vështirësi në realizimin e projekteve të planifikuara me buxhet, por në periudhën e dytë kemi një dinamikë më të theksuar në arritjen e qëllimit në realizimin e projekteve të parapara me buxhet për vitin 2014.

Në kuadër të monitorimit të përmbushjes së premtimeve të dhëna nga Z. Imri Ahmeti kryetar i Komunës së Lipjanit, gjatë fushatës para zgjedhjeve për zgjedhjet lokale 2013, organizata YAHR-e vlerëson se Z. Ahmeti ka bërë përpjekje në përmbushjen e këtyre premtimeve dhe vlerëson me këto rezultatet: Nga 117 premtime të dhëna kemi 93 premtime ose 79.48 % pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit, 5 premtime ose 4.27 % prej tyre ka shenja pozitive në realizimin e premtimit, 4 premtime ose 3.41% ka filluar procesin në rrugë të mirë, 12 premtime ose 10.25% ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve dhe 3 premtime ose 2.56% të realizuar plotësisht, por duhet të mirëtohet parasysh se premtimet e dhëna janë për periudhën katërvjeçare të mandatit dhe kështu që i kanë mbetur edhe ¾ e kohës për plotësimin e premtimeve. Është interesante se në mbledhjen e fundit të Kuvendit Komunal të Lipjanit është miratuar Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2015-2017, ku nga 117 premtimeve të kryetarit¹ në kornizë janë të përfshira vetëm 44 projekte ose 36.70 % prej tyre, që “supozojmë” se kryetari mendon që në vitin e fundit të mandatit të tij ti realizojë premtimet tjera.

Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, që paraqesin dy prej shtyllave kryesore të funksionimit të institucioneve publike, në muajin maj 2014 është arritur të nënshkruhet memorandum i mirëkuptimit në mes Kryetarit të Komunës së Lipjanit Z. Imri Ahmetit dhe përfaqësuesve të organizatës YAHR , për monitorimin e aktiviteteve të Drejtorisë së Prokurimit me qëllim të menaxhimit sa më të mirë parasë publike. Në kuadër të këtij memorandum i përfaqësuesve të organizatës YAHR i lejohet pjesëmarrja në cilësinë e monitoruesve në proceset e hapjes dhe vlerësimit të tenderëve, por një gjë të tillë nuk e ka lejuar Drejtori i Drejtorisë Komunale të Prokurimit me arsyetimin se këto takime janë të gjata.

Në kuadër të punës së Drejtorisë Komunale për Buxhet dhe Financa kemi një performancë të mirë ku buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për periudhën Janar-Shtator 2014 ka arritur që të shpenzohet në masën 80.64 % ose 7,741,401.83 € nga buxheti i alokuar prej 9,600,352.06 € ose 68.30 % nga buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2014, që është 11,333,444.00 €. Po ashtu e kemi një

¹ <http://zgjedhjet2013.weebly.com/programet-e-partive-politike-peumlr-zgjedhjet-2013.html>

performancë të mirë edhe në inkasimin e të hyrave të komunës, edhe pse është hequr taksa komunale për biznese, për periudhën Janar-Shtator 2014 ka arritur që nga planifikimi i të hyrave për vitin 2014 prej 1,166,927.00 € ti realizojë në masën prej 98.36 % ose në vlerën prej 1,147,765.97 €.

Ndërsa, nga aspekti i problemeve që përballen qytetarët Lipjanit janë problemet serioze në fushën e zhvillimit urban në Komunën e Lipjanit. Në Lipjan ka ende disa zona për të cilat nuk është bërë planifikimi hapësinor/urban. Probleme janë evidentuar edhe në zonat ku planet rregulluese janë miratuar, probleme si rezultat i mos-planifikimit të mirë dhe mos-marrjes parasysh të kushteve në terren, dhe nevojave të zonës/qytetit.

Profili i Kryetarit Imri Ahmeti



Imri Ahmeti u lind më 05.08.1964, në fshatin Torlnë, komuna e Lipjanit, shkollën fillore e kreu në fshatin Rufc, ndërsa shkollën e mesme në Lipjan. Është i diplomuar në fakultetin juridik në Universitetin e Prishtinës.

Profesor i Lëndëve Juridike në gjimnazin në Lipjan 1994-1999, Shef i Inspektoratit 1999-2000, Shefi i sektorit për regjistrimin e bizneseve 2004-2007, Kryeshef Ekzekutiv 2004-2007, Këshilltar politik në Kabinetin e Presidentit të Kosovës 2007-2008, Këshilltar i lart politik i Zëvendës së kryeministrit të Qeveris së Kosovës z. Ramë Manaj 2008-2010, zv/ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Qeverinë e Republikës së Kosovës 2010, Deputet në Parlamentin e Kosovës 2011-2013, Nga viti 2013 kryetar i Komunës së Lipjanit.

Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti

Organizata Joqeveritare **Youth Association For Human Rights – YAHR** kemi monitoruar aktivitetet dhe premtimet e kryetarit Imri Ahmeti, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2013 dhe 7 – 12 dhjetor 2013. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin e organizuar nga ne dhe gjithashtu nga dy debatet të mbajtura në “Jeta në Kosovë”, në mes të tjerash Kryetari Ahmet ka premtuar:

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.

- 0 -tregon që asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit,
- 1- tregon se ka shenja pozitive në realizimin e premtimit,
- 2- tregon një proces të filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 3- tregon për një proces të filluar dhe në rrugë të mirë,
- 4- tregon se hapa konkrete kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë dhe,
- 5- tregon se realizimi i premtimit është në fazën drejt finalizimit.

vlerësimi

Lipjan

Asfaltimi dhe ndërtimi i trotuareve në të gjitha rrugët urbane;	0
Rindërtimi i Sheshit Adem Jashari;	0
Shtimi i hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese;	0
Fasadimi, izolimi dhe restaurimi i ndërtesave në qytet (bashkëfinancim);	0
Ndriçimi i të gjitha rrugëve, opsioni ndriçimi solar;	0
Ndërtimi i hapësirave të hapura sportive si dhe rregullimi i Stadiumit të qytetit;	1
Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza;	0
Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve;	3
Ndërtimi i objektit të ri të Komunës	0
Ndërtimi i rrugës për në varrezat e qytetit dhe mirëmbajtja e tyre;	0
Ndërtimin e qendrës zejtare përmes partneritetit publiko privat;	0
Projektimi dhe ndërtimi i nxehtësie qendrore përmes partneritetit publiko privat;	0
Dislokimi tregut të gjelbër dhe ndërtimi në një hapësirë të përshtatshme;	0
Rregullimi i shtratit të lumit “Sitnica” dhe përroskës “Janjevka”.	0
Funksionalizimi i rrjeteve ekzistuese dhe përfundimi ndërtimit të kanalizimit dhe ujësjellësit,	4
Asfaltimi i rrugicave,	3
Asfaltimi i rrugëve deri te varrezat,	4
Ndërtimi i urës dhe asfaltimi i rrugicave në lagjen e ashkalive në Gadime të Ulët,	4
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në rrugët qendrore, opsion ndriçimi solar.	0
Funksionalizimi dhe pajisja e ambulancës ekzistuese me laborator në Gadime të Epër,	3
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitores në Gadime të Epër dhe në Gadime të Ulët,	4
Ndërtimi i rrugës Gadime- Smallushe- Sillovi,	0
Ndërtimi i shkollës fillore në lagjen e “Ibrajve” në Gadime të Epër;	0
Rregullimi i fushave sportive,	0
Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve për regjionin e Gadimes,	0
Gjetja e lokacionit dhe ndërtimi i shkollës fillore në Gadime të Ulët	0
Gjetja e lokacionit për ndërtimin e fushës sportive në Gadime të Ulët,	0
Rregullimi i stadiumit dhe i infrastrukturës përkatëse në Babush të Muhaxhirëve;	0
Rregullimi i nxehtësie qendrore dhe ndërtimi i sallës së sportit për shkollën “Ernest Koliqi” në Babush të Muhaxhirëve.	0
Asfaltimi i rrugës Babush – Cernille përmes bashkëpunimit ndër komunal;	0
Projektet në Llugaxhi, Gumnasellë, Çallapek, Banullë, Glllogovc, Rubovc dhe Kojksë	

Ndërtimi i trotuareve,	0
Përfundimi i objektit të sporteve në Llugaxhi,	0
Mirëmbajtja dhe rregullimi i impiantit të ujërave të zeza për fshatrat Llugaxhi, Gumnasellë. Çallapek, Banullë, Rubovc dhe Kojkë;	0
Asfaltimi i rrugëve të fshatrave,	3
Përfundimi dhe funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,	3
Ndërtimi i shkollës në Gumnasellë dhe Rubovc si dhe përfundimi i shkolles në Banullë dhe në Glllogovc;	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	0
Ndërtimi i fushave të sportit,	0
Renovimi i shkollës së vjetër të fshatit Banullë,	0
Projektet në Sllovi dhe Smallushë	
Hapja dhe asfaltimi i rrugës ndërlidhëse ndërmjet dy rrugëve kryesore të fshatit Sllovi;	1
Asfaltimi i rrugës në lagjen e “Abazve” në Sllovi;	1
Asfaltimi i rrugës ndërlidhëse Sllovi- Smallushë;	0
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve në Sllovi;	0
Ndërtimi i trotuareve dhe i ndriçimit publik-opcion ndriçimi solar;	0
Zgjerimi dhe përfundimi i rrjetit të kanalizimit;	0
Rregullimi i fushës së sportit;	0
Funksionalizimi i QMF.	5
Rregullimi i sallës së sporteve në shkollën e Sllovisë;	0
Renovimi dhe funksionalizimi i shkollës së vjetër në Sllovi;	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve;	0
Ndërtimi i rrugës Sllovi – Gjilan në bashkëpunim ndërkomunal;	0
Projektet në Janjevë, Akllap, Teqe, Brus, Tërbufc, Hanroc, Bukovicë, Okosnicë, Shisharkë dhe Vogaçicë	
Asfaltimi dhe ndërtimi i rrugëve të brendshme me kupëza në Janjevë,	4
Përfundimi i asfaltimit të rrugëve në Brus,	0
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik (opcion ndriçimi solar) në Janjevë,	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitores në Janjevë,	0
Funksionalizimi i ujësjellësit,	4
Ndërtimi i kanalizimit,	0
Ndërtimi i fushave të sportit,	0

Rregullimi i rrethojës se oborrit te shkollës në Janjevë,	0
Ndërtimi i shkollës në Teqe,	0
Renovimi i shkollës në Brus,	0
Ndërtimi i dy urave në fshatin Akllap,	0
Projektet në Konjuh:	
Asfaltimit i rrugëve të fshatit;	0
Ndërtimi i trotuareve;	0
Ndërtimi i rrethojës se shkollës;	0
Ndërtimi i fushës se sportit;	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitores.	0
Projektet në Jetën e Re dhe Grackë e Vjetër	0
Zgjerimi dhe funksionalizimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në të dy fshatrat;	0
Asfaltimi i rrugëve dhe ndërtimi i trotuareve në Jetë të Re dhe Grackë e Vjetër;	0
Lidhja e ujërave të zeza të fshatit Jeta e Re dhe Grackë e Vjetër me impiantin e qytetit të Lipjanit;	0
Restaurimi dhe funksionalizimi i shtëpisë së kulturës në Grackë të Vjetër;	0
Projektet në Topliçan, Grackë e Vogël dhe Bujan	
Përfundimi dhe funksionalizimi i kanalizimit.	0
Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit,	0
Asfaltimit i rrugëve dhe ndërtimi i trotuareve.	0
Asfaltimi i rrugës lidhëse ndërmjet Topliçanit dhe Grackës së Vogël;	0
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Topliçan;	0
Projektet në Bregu i Zi dhe Varigoc	
Ndërtimi i shkollës fillore ne Breg te Zi;	0
Ndërtimi i fushës se sportit ne Breg te Zi;	0
Asfaltimi i rrugicave në Breg te Zi;	0
Ndërtimi i trotuareve ne Breg te Zi;	0
Asfaltimi i rrugës ne Varigoc;	0
Asfaltimi i rrugës Varigovc-Godanc	0
Ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimit ;	0
Projektet në Hallaq i Madh, Hallaq i Vogël, Rufci i Ri, Rufci i Vjetër dhe Ribar i Vogël	
Funksionalizimi dhe ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit dhe kanalizimit,	1
Asfaltimi i rrugicave,	1
Ndërtimi i trotuareve,	0


Ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica,	0
Rregullimi i fushave sportive.	0
Projektet në Kraishtë:	
Përfundimi i shkollës me objekte përcjellëse;	0
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martireve;	0
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;	0
Përfundimi i asfaltimit të rrugicave;	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitorës në Kraishtë;	0
Ndërtimi i trotuareve,	0
Projektet në Ribari i Madh dhe Zllakuqan	
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit,	0
Asfaltimi i rrugëve,	0
Ndërtimi i trotuareve,	0
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martireve;	0
Ndërtimi i QMF-se në Ribar të Madh;	0
Ndërtimi i fushës të sportit.	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitorës në Ribar të Madh.	0
Projektet në Torinë, Poturovc, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Llugë dhe Gllanicë	
Ndërtimi dhe funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimit,	4
Asfaltimi i rrugëve të fshatrave,	5
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik*opsion ndriçimi solar),	0
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Dobrajë të Madhe,	4
Asfaltimi i rrugëve deri të varrezat e fshatit,	0
Rregullimi i ngrohjes qendrore në objektin e shkollave.	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitorës në Dobrajë të Madhe,	5
Ndërtimi i rrugës Dobrajë e Madhe – Magure,	0
Rregullimi i rrethojave dhe rregullimi i oborreve të shkollave,	0
Ndërtimi i rrugës regjionale Lluge- Radeve,	0
Projektet në Magurë, Mirenë, Medvec, Qylagë, Vërshec, Leletiq, Blinajë dhe Vrellë e Goleshit	
Asfaltim i rrugëve,	0
Asfaltimi i rrugës Vërshec-Qylagë,	4
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Magure,	0
Asfaltimi i rrugës së varrezave në Medvec,	0

Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik të rrugëve qendrore,	0
Funksionalizimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve,	4
Ndërtimi i shkollës në Magure dhe Mirenë,	0
Ndërtimi i Qendrës Rinore në Magure,	4
Renovimi i shtëpisë së kulturës në Vrellë,	0
Dhënia e lokacionit dhe ndërtimi i objekteve të banimit social përmes partneritetit publiko privat në Magure,	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	0
Rregullimi i shtratit të lumit në Magure dhe rregullimi i parkut-shëtitores,	0
Projektet në Shalë, Kroimir, Baicë, Resinoc, Kleçkë dhe Divjakë	
Asfaltimi i rrugicave,	0
Asfaltimi i rrugës Shalë-Baicë,	0
Zgjerimi dhe riasfaltimi i rrugës në Resinoc,	0
Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,	4
Ndriçimi publik i rrugëve qendrore,	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	0
Ndërtimi i terreneve sportive,	0
Përfundimi i sallës së sportit në Shalë,	0

- 93 premtime ose 79.48 % pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
- 5 premtime ose 4.27 % ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
- 0 premtime ose 0.00% ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 4 premtime ose 3.41% procesi ka filluar në rrugë të mirë,
- 12 premtime ose 10.25% ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve,
- 3 premtime ose 2.56% të realizuar plotësisht.

Vërejtje: Premtimet janë për periudhën katër vjeçare 2013/2017. Deri tani është shpenzuar 1/4 e kohës.

Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve



Problemet aktuale

Komuna e Lipjanit nuk po arrin kurrë se si ti zgjidhë problemet kryesore që po preokupohen qytetarët e Lipjanit, në këtë nuk e ka pas arritur as ekzekutivi i kaluar, por edhe ekzekutivi tanishëm nuk ka bërë as ndonjë përpjekje serioze në zgjidhjen e tri problemeve kryesore që sot qytetarët e Lipjanit preokupohen dhe ato janë:

- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;
- Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Nuk ka lëvizje në këtë drejtim , edhe pse ne kemi bërë vërejtje që nga raporti e parë mbi punën e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit dhe që është premtim më kryesor nga fushata zgjedhor që nga 2009-ta dhe 2013-tës nga kryetari i komunës Z. Imri Ahmeti.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimit e erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike. Në këtë drejtim kemi një ndryshim nga raporti i kaluar, kemi pasur një iniciativë nga ish-kryetari i komunës Z. Buja me një projekt të turizmit për zhvillim rural në Komunën e Lipjanit, por nga ana e ekzekutivit të tanishëm nuk kemi ndonjë lëvizje të theksuar në këtë drejtim.


Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për periudhën Janar-Shtator 2014 ka arrit që të shpenzohet në masën 80.64 % ose 7,741,401.83 € nga buxheti i alokuar prej 9,600,352.06 € ose 68.30 % nga buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2014, që është 11,333,444.00 €. Kjo shifër është shifra e mirë që është arritur ndonjëherë në shpenzimin e buxhetit në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe e pritët të shpenzohen në tre mujorin e fundit të 2014. Po ashtu e kemi një performancë të mirë edhe në inkasimin e të hyrave vetanake të komunës, edhe pse është hequr taksa për biznese komuna për periudhën Janar-Shtator 2014 ka arritur që nga planifikimi i të hyrave për vitin 2014 prej 1,166,927.00 € ti realizojë në masën prej 98.36 % ose në vlerën prej 1,147,765.97 €.

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencione t dhe transfere	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2015	8,297,000 ▲	956,030 ▼	198,390 ▼	157,000 ▼	2,790,834 ▼	12,399,254 ▲
2014	6,793,498 ▲	983,145 ▲	256,500 ▼	200,000 ▲	3,100,301 ▼	11,333,444 ▼
2013	6,738,235 ▲	815,573 ▲	204,746 ▲	179,550 ▲	3,301,197 ▼	11,973,991 ▲
2012	6,744,398 ▲	742,386 ▼	119,972 ▼	138,064 ▲	3,606,440 ▼	11,795,467.76 ▲
2011	6,580,682 ▲	752,815 ▲	130,707 ▼	88,273 ▲	4,113,220 ▲	11.317.613,69 ▲
2010	5,069,000 ▲	698,000 ▲	133,000 ▼	78,000 ■	3,376,000 ▲	9,456,417 ▲
2009	4,425,264 ▲	512,394 ▼	112,154 ■	80,000 ■	2,325,154 ▲	7,454,966 ▲
2008	3,868,282 ▲	554,288 ▲	112,154 ▼	80,000 ■	1,239,909 ▲	5,854,633 ▲
2007	3,718,294 ▼	537,335 ▼	202,154 ▲	80,000 ▼	1,127,138 ▲	5,664,921 ▲
2006	3,731,341 ▲	610,147 ▼	78,577 ▼	100,000 ▲	1,070,849 ▼	5,590,914 ▼
2005	3,696,996 ▼	621,827 ▼	126,381 ■	64,000 ■	1,180,077 ▲	5,689,281 ▲
2004	3,701,207 ▲	1,135,854 ▼	-	-	721,431 ▲	5,558,492 ▲
2003	2,770,014 ■	1,144,006 ■	-	-	465,113 ■	4,528,532 ■

▲ Rritje, ▼ Zvogëlim, ■ Nivel i njëjtë/mos ndryshim

Tabela krahasuese e planifikimeve buxhetore 2012/2015 për Komunën e Lipjanit



Investimet kapitale dhe projektet e planifikuara

Sfidë e drejtorisë së Prokurimit në fillim vitit 2014 për komunën e Lipjanit ka qenë vonesa e drejtorive të tjera si p.sh: drejtorisë të shërbimeve publike dhe drejtorisë për planifikimit dhe urbanizmit të cilat kanë ndikuar në drejtorinë e prokurimit publik në realizimin e investimeve kapitale për një periudhë katër mujore të cilat do të paraqesin problem në realizimin e proceduarave tenderuese për shkak të fluksit të madh të punëve të cilat gjithashtu pengon realizimin me kohë të investimeve kapitale të planifikuara për vitin 2014. YAHR-i gjatë monitorimit të aktiviteteve të drejtorisë së Prokurimit në Komunën e Lipjanit ka vërejtur këto parregullsia: 12 Mars 2014: pas ankesës së ofertuesve në tenderin: “Tërheqë të automjeteve sipas porosisë” tek Agjencinë kundër Korrupsionit (AKK), ku AKK-ja del me opinion ku kërkohet nga autoritetet kontraktuese të komunës së Lipjanit të marrin veprime të nevojshme për evitimin e shkeljeve të evendituara në lidhje me tenderin në fjalë, që në mënyrë që të respektohet dispozita përkatëse e Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik. Ku sipas opinion të AKK-së, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e Prokurimit Publik të Kosovës, ku në njoftimin për kontratë, tek pika II.1.5 Përshkrimi i shkurtër i lëndës, është kërkuar: Tërheqja dhe bartja e të gjitha llojeve të automjeteve sipas porosisë (shërbimi i merimangës) dhe deponimi i tyre në parking (pllac) i cili është vend parking i sigurt për këtë shërbim dhe i cili duhet të jetë jo më larg se 5 km nga qyteti i Lipjanit.

LISTA E TËNDERVE TË KONTRAKTUARA NGA DREJTORIA KOMUNALE E PROKURIMIT NË LIPJAN GJATË PERIUdhës JANAR-TETOR 2014²

Nr.	Nr. i prokurimit	Titulli	Fituesi	Shuma e kontraktuar
1	LI613-14-001-2-3-6	Transporti i nxënësve me nevoja te veçanta nga vendbanimi deri te shkolla Haredin Bajrami ne Magure Llot-I - ri tenderim	Auto taxi “Sherif Shasivari”.	1,725.00€
2	LI613-14-001-2-3-6	I, Transporti i nxënësve me nevoja te veçanta nga vendbanimi deri te shkolla Vëllezërit Frasheri ne Lipjan Lloti-II,dhe anasjelltas” - ri tenderim	Auto taxi “Merxhan Aliu”.	2,750.00€
3	LI613-14-001-2-3-6	Transporti i nxënësve me nevoja te veçanta nga vendbanimi deri te shkolla Vëllezërit Frasheri ne Lipjan Lloti-II,dhe anasjelltas” - ri tenderim	Auto taxi “Merxhan Aliu”.	2,750.00€
4	LI613-14-004-1-3-6	Furnizimi dhe montimi i dyerve ne shkollën “Vëllezërit Frasheri”-	ITBM Solutions	4,976.65€
5	LI613-14-003-5-3-6	Rregullimi i press konferencave dhe zyrës se kryetarit	Ideadesing	5991.50 €

² Shënimet janë marrë nga ueb faqja zyrtare e KRPP-së (Komisionit Rregulator të Prokurimit Publik të Kosovës) deri në ora 12.00 të datës 7 tetor 2014.

6	LI613-14-005-5-3-6	Rregullimi i kanalizimit fekale ne rrugën Shqipëria dhe 2 Korriku	: Hidrotek	1,387.55 €
7	LI613-14-010-2-2-1	Mirëmbajtja (sanimi) i rrugëve te asfaltuara si dhe mirëmbajtja (sanimi) i rrugëve te kategorisë se IV në Komunën e Lipjanit.	“EL-BAU” SHPK	74.85€
8	LI613-14-015-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ribar i Madh-faza II	“PAPEMBURG-ADRIANI”	10,8682.72€
9	LI613-14-014-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobrajë e Madhe-faza II	“LINDA” SHPK	72,255.56 €
10	LI613-14-013-1-3-6	Furnizimi me uniforma verore për zjarre fikës	Arta-Tex	2,130.00.€
11	LI613-14-016-5-2-1	Meremetimi i objekteve të QKMF-së	Termomontimi -Prishtinë	13,264.00
12	LI613-14-011-1-3-6	FURNIZIMI ME PAISJE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	NTP“VLERA”	4,756.00€
13	LI613-14-017-1-3-6	Furnizimi me mobile të QKMF-së	Metali- Pozhoran	6,277.00.€
14	LI613-14-007-1-2-1	Furnizimi i institucioneve të komunës së Lipjanit me naftë dhe derivate të naftës	“Standard Benz”.	26,415.00€
15	LI613-14-019-5-2-1	Asfaltimi i rrugës në fshatin Qylagë	“Eurotrans&eu-Abi”	86,339.69 €
16	LI613-14-018-5-2-1	Asfaltimi i rrugës në fshatin Gadime e epërme	“Kosova Asfalt	139,041.89 €
17	LI613-14-028-5-2-1	Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Lipjanit	N.P.SH “Parajsa”-Lipjan	104.275,62€
18	LI613-14-025-5-2-1	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Kojskë	NTP “FERIZI”-LIPJAN	65.966,52€
19	LI613-14-026-5-2-1	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Ribar i Vogël	N.T.P “FERIZI”-Lipjan	41.880,50€
20	LI613-14-027-5-2-1	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Marevc	N.SH.P “Dimi Bau”-Lipjan	68.266,00€
21	LI613-14-019-2-2-1	Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve të qytetit të Lipjanit, Pastrimi dimëror i rrugëve të komunës së Lipjanit dhe bartja e mbeturinave nga institucionet e komunës së Lipjanit.	K.R.M “PASTRIMI” SH.A-PRISHTINË	140,017.63
22	LI613-14-022-5-2-1	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Llugë	NTP “Eing-com”-Podujevë	44,993.03€
23	LI613-14-033-1-2-1	Furnizimi me thëngjill për shkolla,	NTSH “AOME”-Prishtinë	30,236.00.€

		QKMF-së dhe shtëpinë e Kulturës		
24	LI613-14-030-1-2-1	Furnizimi me dru për shkolla, QKMF-në dhe shtëpinë e kulturës të komunës se Lipjanit	NTP "JETA"	53,424.80 €
25	LI613-14-012-2-2-1	Furnizimi dhe mirëmbajtja e shenjave horizontale dhe vertikale në komunën e Lipjanit	NTP "Jona" shpk	90.50 €
26	LI613-14-029-1-2-1	Furnizimi me aparate të Teknologjisë Informative	NTP "Vlera"	6,415.00 €
27	LI613-14-032-5-2-1	Ndërtimi i sallës së sporteve në Dobrajë të Madhe	"Toni&Astraplan" SHPK	135,776.25 €
28	LI613-14-036-1-2-1	Furnizimi me aparate medicinave për QKMF-në	NTSH " Koslabor"- Suharekë	19,890.00.€
29	LI613-14-037-5-2-1	Asfaltimi i rrugës në fshatin Ruvç i Ri	"Eurotrans&euu-Abi"	79,716.57 €
30	LI613-14-039-5-2-1	Ndërtimi i Qendrës Rinore në Magurë të Lipjanit- Faza e parë, sipas specifikimit teknik të dhënë në dosje të tenderit dhe projektit kryesor.	NTP "Archvision dhe Bajraktari"-LIPJAN	89,599.10€

Projektet e planifikuara dhe ato të realizuara gjatë vitit 2014

	Të planifikuara	Realizimi
Asfaltimi I rrugës Shqipëria dhe Hajredin Bajrami	450,000.00	Ka filluar
Asfaltimi I rrugëve brenda ne fsh.Gadime	170,000.00	Jo
Asfaltimi I rrugëve brenda fsh. Ribar I Madh	150,000.00	E përfunduar
Asfaltimi I rrugëve ne qytetin e Lipjanit	100,000.00	Jo
Asfaltimi I rrugëve ne fsh.Qylage	100,000.00	E përfunduar
Asfaltimi I rrugëve brenda fshatit Bujan	100,000.00	Jo
Asfaltimi I rrugës ne fshatin Divjak	100,000.00	Jo
Rregullimi I trotuareve ne qytetin e Lipjanit	70,000.00	Jo
Rregullimi I kanalizimit fekal fsh.Kojske	100,000.00	Ka filluar
Rregullimi I kanalizimit fekal ne fshatin Lluge	100,000.00	Jo
Rregullimi I kanalizimit fekal ne fshatin Marevc	70,000.00	Ka filluar
Asfaltimi I rrugës ne zonën e re te qytetit Z1.3dhe Z1.4 ne qytetin e	50,000.00	Jo

Lipjanit		
Ndërtimi I rrjetit të kanalizimit në zonën e re të qytetit Z1.3 dhe Z1.4 në qytetin e Lipjanit	50,000.00	Jo
Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara	10,000.00	Jo
Bashkëfinancim me donator	120,582.00	Në realizim
Zgjerimi I rrjetit të Kanalizimit në qytet	100,000.00	Ka filluar
Rregullimi I hapësirave për kontejner në qytet	52,025.00	Jo
Eliminimi I deponive të egra	50,000.00	Jo
Rregullimi I urave në Komunën e Lipjanit	70,000.00	Në proces
Asfaltimi I rrugëve brenda fshatit Dobraj e Madhe	100,000.00	Në realizim
Asfaltimi I rrugëve brenda fshatit Rucf I Ri	100,000.00	Në realizim
Rregullimi I kanalizimit fekal fsh.Ribar I Vogel	50,000.00	Në realizim
Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal I rrugëve	20,000.00	Jo
Rregullimi I stacioneve të autobusëve Lipjan	50,000.00	Jo
Rrjeti I ujësjellësit për 20 fshatra	200,000.00	Jo
Renovimi I Objekteve shëndetësore	27,000.00	Në realizim
Furnizimi me pajisje tjera objekte shëndetësore	39,694.00	Në realizim
Ndërtimi I sallës sportive pranë shkollës fillore në fshatin Dobraj e Madhe	251,000.00	Në realizim
Ndërtimi I qendrës rinore Magure	100,000.00	Në realizim

Plani I ndarjeve buxhetore të shpenzimeve të Komunës së Lipjanit për vitet 2015-2017

2015			
Projektet	Kostoja totale	Transferim qeveritare	Të hyrat vetanake
Bashkëfinancim me Donatorë	144,000.00		144,000.00
Kanalizimi në Fshatin Gadime e Ulët (2011)	84,128.54	84,128.54	
Ndërtimi i Trotuareve në Fshatin Gadime e Epërme dhe Gadime e Ulët (2013)	74,632.98	74,632.98	
Asfaltimi i Rrugëve në Gadime të Ulet	110,000.00	110,000.00	
Ndërtimi i Rrjetit të Kanalizimit në Fshatin Janjevë (2013)	178,667.00	65,785.00	112,882.81
Asfaltimi i rrugëve në Fshatin Brus	50,000.00	50,000.00	
Asfaltimi i Rrugëve brenda Qytetit të Lipjanit (2013)	93,357.00	93,357.00	
Asfaltimi i Rrugëve në Fshatin Krojmir, Lagjja e Pojatave	60,000.00	60,000.00	
Asfaltimi i Rrugëve në Sllovi-Smallushë	120,000.00	120,000.00	
Asfaltimi i Rrugëve në Fshatin Sllovi (2012)	45,482.01	45,482.01	
Asfaltimi i Rrugëve në Fshatin Sllovi-Turbovc (2011)	8,731.10	8,731.10	
Mirëmbajtja e Rrjeteve të Kanalizimit	20,000.00		20,000.00
Ndërtimi i Rrjetit të Kanalizimit në Fshatin Torinë (2013)	26,476.67	26,476.67	
Rehabilitimi i Kanalizimit në Fshatin Bujari	20,000.00		20,000.00
Rehabilitimi i Rrjeteve të kanalizimeve në Kraishtë, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Poturovc, Torinë, Dobrajë e Madhe, Llughë)	56,460.16	36,460.16	20,000.00

Ndërtimi i Rrjetit të Kanalizimit në Fshatin Mirenë	25,000.00	25,000.00	
Asfaltimi i rrugëve në Baicë	55,000.00	55,000.00	
Asfaltimi i Rrugëve brenda Fshatit Dobrajë e Madhe	80,000.00	50,000.00	30,000.00
Asfaltimi i Rrugëve brenda Fshatit Magure	100,000.00	100,000.00	
Zgjerim i Rrjetit të Kanalizimit brenda fshatrave Dobrajë, Ribar i Madh, Shalë	40,000.00	30,000.00	10,000.00
Mirëmbajtja e Rrugëve te Asfaltuara	10,000.00		10,000.00
Rregullimi i Varrezave	10,000.00	10,000.00	
Pastrimi dhe Hapja e Lumenjve	20,000.00		20,000.00
Rehabilitimi i Ndrçimit Publik në Gracke të Vjetër	10,000.00	10,000.00	
Asfaltimi në fshatin Gadime e Epërme	50,000.00	50,000.00	
Asfaltimi i rrugëve brenda në fshatin Bujan	60,000.00	60,000.00	
Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Ribar i Madh - Faza II	65,000.00	65,000.00	
Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Rufc i Ri	35,000.00		35,000.00
Mirëmbajtja e Rrugëve Lokale	10,000.00		10,000.00
Rregullimi i Parkingjeve në Qytetin e Lipjanit	15,353.19		15,353.19
Rregullimi i Vendndalimit te Autobusëve te Qendra Rinore Sportive	20,000.00	20,000.00	
Ujësjiellësi Shale (2013)	17,990.00		17,990.00
Mirëmbajtja e Ndrçimit Publik	15,000.00	15,000.00	
Asfaltimi i Rrugëve në Fshatin Janjeve	50,000.00	50,000.00	
Kanalizimi në fshatin Blinajë (2013)	100,000.00		100,000.00
Ndërtimi i Sallës së Sportit në Fshatin Llugaxhi (2011)	78,406.13	78,406.13	
Ndërtimi i Sallës së Sporteve pranë SHF Dobrajë e Madhe - Faza II	57,046.63	57,046.63	
Ndërtimi i Fushave Sportive në fshatrat Janjevë, Sllovi, Gadime e Epërme	60,000.00	60,000.00	
Renovimi i Stadiumit të Qytetit Ulpiana	70,000.00		70,000.00
Renovimi i Sallës në Shtëpinë e Kulturës	20,000.00		20,000.00
Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Shale	68,510.00	28,510.00	40,000.00
Ndërtimi i Shkollës Filllore në Glogovc (2011)	121,279.45	121,279.45	
Rregullimi rrethojës në shkollën Filllore Katër Dëshmorët në Krojmir	15,000.00	15,000.00	
Instalimi i Sistemit të Monitorimit me Kamera në Shkollat Filllore Vëllezërit Frashëri dhe Ismail Luma ne Lipjan	5,140.00	5,140.00	
Rregullimi i Infrastrukturës në SH.F. Shtjefan Gjeqovi në Brus	5,000.00	5,000.00	
Rregullimi i Infrastrukturës në SH.F. Dy Dëshmorët në Dobrajë të Madhe	6,266.20	6,266.20	
Rregullimi i infrastrukturës në SH.F. Vezir Kolshi-Baicë	5,000.00	5,000.00	
Rregullimi i Infrastrukturës në Sh.F. 7Marsi-Poturovc	14,200.00	14,200.00	
Rrethoja në Sh.F. në Fshatin Konjuh	9,800.00	9,800.00	
Rregullimi i Infrastrukturës në Sh.F. të fshatit Glogovc	14,000.00	14,000.00	
Rregullimi i Infrastrukturës në Sh.F. Migjeni në Rufc te Ri	6,906.13	6,906.13	
Rregullimi i Infrastrukturës në Sh.F. Qylage	8,000.00	8,000.00	
Renovimi i Objektit në Sh.F. Rexhep Akllapi-Akllap	20,000.00	20,000.00	
Rrethoja në Sh.F. Ismail Luma -Lipjan	18,500.00	18,500.00	
Rregullimi i Infrastrukturës në Sh.F. ne Medvec	3,000.00	3,000.00	
Rregullimi i Infrastrukturës në Sh.F. në Gadime të Ulët	25,000.00	25,000.00	
Blerja e dollapëve në Shkollat Filllore Ismail Luma dhe Vëllezërit Frasheri ne Lipjan	9,500.00	9,500.00	
2016			
Bashkëfinancimi me Donatorë	110,000.00	110,000.00	

Mirëmbajtja e ndriçimit Publik	20,000.00		20,000.00
Pastrimi i lumenjve ne Komunën e Lipjanit	25,000.00		25,000.00
Mirëmbajtja dhe Reabilitimi i Rrjeteve te Kanalizimeve	20,000.00		20,000.00
Kanalizimi në fshatin Rubovc (2013)	232,189.20	211,405.45	20,783.75
Eliminimi I Deponive te Egra	70,000.00		70,000.00
Ndërtimi I Trotuareve në Fshatrat Janjeve, Slllovi, Banulle, Glogovc, Rufc i Vjeter, Ribar i Vogel, Hallaq i Vogel, Rufc i Ri dhe Konjuh	290,942.00	170,942.00	120,000.00
Mirëmbajtja e rrugëve te asfaltuara	10,000.00		10,000.00
Asfaltimi i Rrugëve ne Qytetin e Lipjanit	75,000.00	75,000.00	
Asfaltimi I Rrugëve ne fshatin Blinaj	50,000.00	50,000.00	
Asfaltimi I Rrugëve ne fshatrat Qylag-Dobraj e Madhe	54,500.00	54,500.00	
Asfaltimi ne Fshatin Banulle	55,000.00	55,000.00	
Asfaltimi ne Fshatin Glogovc	60,000.00	60,000.00	
Asfaltim ne Resinove	40,000.00	40,000.00	
Asfaltim ne Fshatin Vrelle	41,000.00	41,000.00	
Meremetimi i Objekteve Shëndetësore	10,000.00		10,000.00
Blerja e Autoambulancës	25,000.00	25,000.00	
Blerja e Pajisjeve	5,000.00	5,000.00	
Ndërtimi i Qendrës Rinore në Magure Faza II	348,033.05	289,600.55	58,432.50
Ndërtimi i fushave Sportive ne fshatrat:Smallushe, Topliqan, Gracke, Poturovc, Krojmir, Rufc i Vjeter, Rubovc dhe Leletiq	220,320.32	200,000.00	20,320.32
Ndërtimi i Shkollës Fillore në Bujari (2013)	392844.43		392844.43
Ndërtimi i Shkollës Fillore në Mirenë	220000	220000	
2017			
Bashkëfinancim me Donatorë	115,000.00		115,000.00
Ndërtimi i rjetit të kanalizimit në fshatin Akllap	145,000.00	95,000.00	50,000.00
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Leletiq	125,000.00	75,000.00	50,000.00
Ndërtimi I trotuareve në Fshatrat Smallushë, Topliqan, Grackë, Magure	120,000.00		120,000.00
Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Akllap	53,000.00	53,000.00	
Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Slllovi	59,339.00	59,339.00	
Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Rubovc	56,000.00	56,000.00	
Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Shalë	50,000.00	50,000.00	
Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Mirenë	55,000.00	55,000.00	
Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Bregu i Zi	45,000.00	45,000.00	
Pastrimi i Lumenjve në Fshatrat Janjevë, Banullë, Glogovc, Konjuh, Ribar i Madh, Magure dhe Dobrajë e Madhe	120,000.00		120,000.00
Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit ne fshatin Baicë	155,000.00	155,000.00	
Ndërtimi i Shkollës Fillore në fshatin Magure	600,000.00	357,819.00	242,181.00
Ndërtimi i Shkollës Fillore në fshatin Rubovc	220,000.00	200,000.00	20,000.00
Ndërtimi i Shkollës së Mesme Adem Gllavica në Lipjan	600,000.00	500,000.00	100,000.00

Administrata komunale

Në vitin 2014, në Komunën e Lipjanit e kemi këtë gjendje të punësuarve në tre sektorët publik: arsim 1,068, shëndetësi nga 233 , administratë nga 205 në vitin 2011 në 185 në vitin 2012 janë të punësuar gjithsej 1,483 qytetarë. Vetëm në administratën komunale janë të punësuar momentalisht 185 shërbyes. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 10/46, ku sipas së cilit në komunat me popullsi nën 100,000 banorë administratat lokale duhet të kenë 1 shërbyes civil për 620 banorë, del se komuna e Lipjanit me rreth 60,000 banorë duhet të ketë më së shumti 97 shërbyes civil. Sipas kësaj, administrata komunale e Lipjanit është e tej ngarkuar me staf. Duke u bazuar në statistikat e strukturës kualifikuese të administratës së komunës së Lipjanit shumica e punëtorëve janë me shkollë të mesme, vetëm 35% prej tyre janë me përgatitje të lartë, gjegjësisht me fakultet.

Arsimi

Me nisjes së mandatit të parë të kryetari aktual Imri Ahmeti, sistemi arsimor në Lipjan është përballur me këto probleme kryesore:

1. Gjendja jo e mirë e infrastrukturës shkollore;
3. Numri i madh i nxënësve për paralele në shkollat e mesme;
3. Mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik;

Me 1 Tetor 2014, Organizata Joqeveritare YAHR nëpër mes kësaj komunikate për media e ka ngritë problemin lidhur peshën e rëndë të çantave të fëmijëve nëpër shkollat fillore të komunës së Lipjanit, në të cilat ata bartin tekstet dhe materialet e tjera mësimore. Në bazë të një hulumtimi të organizatës sonë, kemi konstatuar se një çantë mesatarisht e ka peshën nga 5-10 kg varësisht nga niveli klasore të nxënësve, që kjo është në kundërshtim me standardet të përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetit, ku ngarkesa fizike të fëmijët nuk guxon të kalojë 10 përqindëshin e peshës trupore të fëmijëve. Çdo gjë më e rëndë se aq, mund të jetë e dëmshme për shpinën e fëmijës dhe bart pasoja për të ardhmen. Çantat e mëdha dhe të mbingarkuara po shkaktojnë jo vetëm lodhje të nxënësve, por edhe dëmtime afatgjatë në shtyllën kurrizore.

Po ashtu, ndër problemet tjera që janë evidentuara në vitin 2013 janë se pjesa dërmuese e shkollave në Komunën e Lipjanit kanë qenë në gjendje të keqe infrastrukture .

Problemet të cilët aktualisht hasën në sistemin arsimor në Lipjan janë ato në shkollat e mesme, përkatësisht me numrin e madh të nxënësve në to që në shumicën e rasteve ky numër është afërsisht 40 nxënës për një klasë dhe po ashtu problem në vete paraqet mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik.

Numri i nxënësve dhe i personelit arsimor në Komunën e Lipjanit ³				
Arsimi Komunal			Personeli	
	Nr. i institucioneve	Nr. i nxënësve	Nr. i Mësimdhënësve	Nr. i personelit tjetër
Institucione parashkollore publike	1	114	8	9
Shkolla fillore publike	51	11667	674	158
Shkolla të mesme publike	3	3545	183	32

³ http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Statistikat_e_arsimit_ne_Kosove_2013_14.pdf

Shkolla apo kolegje private	1	/	/	/
Gjithsej	56			

Shëndetësia

Në Komunën e Lipjanit funksionojnë një QKMF, 4 QMF dhe 6 ambulant të mjekësisë familjare. Vetëm në QKMF në qytetin e Lipjanit punohet me orar 24 orësh, kurse në QMF punohet pesë ditë në javë për 12 orë në ditë. Tri ambulantë punojnë vetëm dy ditë në javë për tetë orë në ditë. Në shëndetësinë primare të Lipjanit janë të punësuar 234 punonjës, prej tyre 132 femra, ku vetëm një femër është në pozitë udhëheqëse.

Me 3 Mars 2014, YAHR nëpër mes një komunikate patë shprehur shqetësimin mbi gjendjen në sektorin e shëndetësisë, për kundër angazhimeve të shumta të Drejtorisë Komunal për Shëndetësi në Komunën e Lipjanit, që të përmirësojë gjendjen ekzistuese në sektorin shëndetësor, prapë se prapë gjendja ka qenë katastrofale në këtë sektor, me fajin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ka pasur mungesë të gjerave elementare duke filluar nga shiringat, gypin përcjellës për infuzione, dorëzat sterilizuese për personelin mjekësorë, fashat, cilindrin mbushës me oksigjen dhe plotë gjëra të tjera që i duhen një pacienti për të marrë një intervenim emergjent. Me këtë përveç që pacient do të kishte shpenzime materiale, ata rrezikohen edhe me humbjen e kohës për të marrë ndonjë intervenim mjekësorë për shëndetin e tij dhe njëkohësisht me këtë i rrezikohet edhe jeta e tij në raste të rënda.

Pas thirrjes së organizatës sonë ndaj ekzekutivit të Komunës së Lipjanit që të angazhohet maksimalisht në kujdesin shëndetësor për qytetarët e vetë, drejtoria komunale e shëndetësisë është përgjigjur pozitivisht, duke ndarë mjete buxhetore për plotësimin e këtyre mungesave të medikamenteve e cila është si pasojë e një menaxhim të keq nga Ministria e Shëndetësisë.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Komunën e Lipjanit përllogariten sipas Rregullores komunale mbi pronën. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i ka caktuar tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore.

Rekomandimet:

1. Angazhim më i madh i Kryetarit të Komunës në përmbushjen e premtimeve elektorale;
2. Menaxhim më i mirë dhe transparencë më e madhe në shpenzimin e fondeve publike;
3. Ofrim i qasjes në informacion dhe dokumentacion për të gjitha palët e interesuara;
4. Komunikim më kualitativ me shoqërinë civile dhe media;
5. Organizimi më i shpeshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe buxhetit komunal;
6. Marrja parasysh e propozimeve të qytetarëve për investime kapitale sipas mundësive buxhetore;

7. Në fillim të vitit të paraqitet në Kuvendin Komunal, Plani Dinamik i realizimit të projekteve nga Lista e Investimeve Kapitale;
8. Mbikëqyrje më efikase e realizimit të punëve në projektet kapitale, veçanërisht në projektet infrastrukturore;
9. Mbrojtje më e mirë e pronës publike mbi baza ligjore ,
10. Përmirësimi i bazës të dhënave mbi tatimin në pronë,
11. Kuvendi Komunal I Lipjanit është i obliguar të hartojë një plan të veprimit për transparencë të aktiviteteve të saj karshi qytetarëve të saj.
12. Integrimin e një programi kompjuterikë kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacione për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë,

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shkurt-Qershor, 2014.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2014. (<http://mefrks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012-2014 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2013 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2012.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2013.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2013. Janar, 2014.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2014. Shtator, 2014.
12. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndhmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2014.
15. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2014.
16. Programi zgjedhor i LDK-së dega Lipjan , Nëntor 2013,
17. Raporti Komunal Lipjan i Institutit për studime të Avancuara GAP , 2014,
18. Zyra Komunale për punësim në Lipjan. Maj 2012,
19. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar-Tetor 2014,
20. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit Janar-Tetor 2014,
21. Komunikatat për media të YAHR-it Janar-Tetor 2014.

